



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIALEZHË

Nr 6174/1 Prot.,

Lezhë, me 21.06.2022

PROJEKT -VENDIM

Nr _____, Datë 21.06.2022

PËR

**DISA SHITESA E NDRYSHIME NE VKB NR.157, DATË 17.11.2021
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR
SHËRBIMET PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT FISKALE,
STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË
PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit të antarëve ;

V E N D O S I

1. Të bëjë ndryshim të pikës **A.2.a.7. “Afatet e pagesës së taksës”**, si më poshtë :
 - a. **Ishte** : “Për kategorinë “Biznes”, ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 31 Maj e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
 - b. **Bëhet**: “Për kategorinë “Biznes”, ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
2. Të bëjë ndryshim të pikës **A.2.b.5. “Afatet e pagesës”**, si më poshtë :
 - a. **Ishte** : “Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës eshte data 31 Maj. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
 - b. **Bëhet**: “Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës eshte data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
3. Të bëjë ndryshim të pikës **A.2.c.4. “Mënyra e pagesës”**, si më poshtë :
 - a. **Ishte** : “Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës është data 31 Maj. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.

- b. **Bëhet:** “Detyrimi për Taksën mbi Truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një kësht. Afati i pagesës është data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
4. Të bëjë ndryshim të pikës A.6.5. “Afati i pagesës”, nën pikat A.6.5.1 dhe A.6.5.2, si më poshtë:
- a. **Ishte** pika A.6.5.1 : Për kategorine 1-rë, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31 Maj të vitit fiskal, ndërsa për subjektet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 31 Maj, detyrimi llogaritet dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit.
- b. **Bëhet :** Për kategorine 1-rë, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal, ndërsa për subjektet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 30 Qershor, detyrimi llogaritet dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit.
- c. **Ishte** pika A.6.5.2 : “Për kategorinë e 2-të, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31 Maj të vitit fiskal, ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë”.
- d. **Bëhet :** Për kategorinë e 2-të, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal, ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë.
5. Të bëjë ndryshim të pikës B.1.3.b.5 “Afati i pagesës”, si më poshtë :
- a. **Ishte :** “Afati i pagesës për kategorinë e taksapaguesve “Biznes” është me dy kështe të barabarta, brenda datës “31 Maj” dhe “30 Gusht” të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.”
- b. **Bëhet:** “Afati i pagesës për kategorinë e taksapaguesve “Biznes” është me dy kështe të barabarta, brenda datës “30 Qershor” dhe “30 Gusht” të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR”.
6. Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik 2022.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
PJERIN NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIALEZHË

Nr 6144 Prot.,

Lezhë, me 21 qel. 2022

RELACION

PËR

**DISA SHITESA E NDRYSHIME NE VKB NR.157, DATË 17.11.2021
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR
SHËRBIMET PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT FISKALE,
STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË
PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nisur nga situata jo e mirë ekonomike, për shkak të pasojave të luftës në Ukrainë, me të cilën po përballen të gjitha kategoritë e taksapaguesve, me qëllim krijimin e lehtësirave fiskale ndaj tyre, gjykojmë të arsyeshme ndryshimin e afateve të pagesave për disa prej zërave kryesorë të taksave dhe tarifave vendore.

Ndryshimet që në propozojmë të bëjmë në VKB e sipërcituar, kanë të bëjnë me zërat e taksave për pasurinë për kategoritë e taksapaguesve biznes dhe familjarë si dhe tarifatat e shërbimeve publike, për kategorinë biznes, si më poshtë :

- Me zërin e taksës mbi pasurinë për taksat mbi ndërtesat, e cila kishte afatin e pagesës brenda datës 31 maj, të cilin ne e ndryshojmë dhe caktojmë si afat datën 30 Qershor të vitit korent.
- Me zërin e taksës mbi tokën bujqësore, e cila kishte afatin e pagesës brenda datës 31 maj, të cilin ne e ndryshojmë dhe caktojmë si afat datën 30 Qershor të vitit korent.
- Me zërin e taksës mbi truallin, e cila kishte afatin e pagesës brenda datës 31 maj, të cilin ne e ndryshojmë dhe caktojmë si afat datën 30 Qershor të vitit korent.
- Me zërin e taksës mbi tabelat, për dy kategoritë e para dhe e dyta, të cilat kishin afatin e pagesës brenda datës 31 maj, të cilin e ndryshojmë dhe caktojmë si afat datën 30 Qershor të vitit korent.
- Ndryshimi i fundit ka të bëjë me tarifatat e shërbimeve publike për kategorinë biznes, e cila ishte e ndarë me dy këste të barabarta. Ne propozojmë të bëjmë ndryshime vetëm për këstin e parë, i cili e kishte afatin brenda datës 31 maj, të cilin ne e ndryshojmë dhe caktojmë si afat datën 30 Qershor të vitit korent.

**Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik 2022.
Faleminderit për bashkëpunimin e deritanishëm në vendimmarrjen tuaj,**

KRYETAR
PJERIN NDREU

